



A.nr.624/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.624/2026, të datës 15.06.2026, të parashtruar nga ankuesi A.A, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Hajzer Salihu nga Prishtina, kundër Vendimit me numër protokoli 01-M 2959/26, të datës 29.05.2026, të Ministres së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.08.2026, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet si i e bazuar** ankesa A.nr.624/2026, e datës 15.06.2026, e parashtruar nga ankuesi A.A.
- II. Shfuqizohet** Vendimi numër protokoli 01-M 2959/26, i datës 29.05.2026, i Ministres së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- III. Obligohet** Ministria e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që në zbatim të këtij vendimi emërimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ta bëjë në pajtim të plotë me ligjin material dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra si në pikën III të dispozitivit.

## A r s y e t i m

Ankuesi A.A, (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesi), më datë 12.06.2026, përmes emailit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 15.06.2026 nën shenjë A.nr.624/2026, kundër Vendimit numër protokoli 01-M 2959/26, të datës 29.05.2026, të Ministres së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, më pretendimin se akti i kontestuar është përcjell me shkelje ligjore materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ( tutje vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 17.06.2026

ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa, kjo e fundit, më datë 23.06.2025, ka përcjell dokumentacionin lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2663/2026, të datës 15.06.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin numër protokolli 01-M 2959/26, të datës 29.05.2026, të Ministres së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Vendimin me Nr. 39/2026 të datës 26.05.2026 të U.D Drejtores Ekzekutive të AKK-së; Vendimin me Nr. 15/2026 të datës 21.05.2026 të Ministres së MMPH-së; Vendimin A.nr.383/2026 të KPMSHC-së; Vendimin Nr.06/2026, të datës 25.03.2026, të Ministres së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Akt Emërimit AE.Nr.01/2022 të datës 01.08.2022 të ankuesit; Autorizimin e datës 30.03.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.06.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 22.06.2026; Vendimin me Nr. 40/2026 të datës 26.05.2026 të U.D Drejtores Ekzekutive të AKK-së; Vendimin M-01 2847/26 të datës 21.05.2026 të Ministres së MMPH-së; Organogramin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.04.2026; Vendimin me Nr. 01/15 të datës 27.02.2015, për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për IKIH.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se pretendimet ankimore janë të bazuara, **sepse:**

#### **I. Gjendja e çështjes**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se:

-Ankuesi sipas Aktit të Emërimit AE.Nr.01/2022, të datës 01.08.2022, është i punësuar në pozitën Drejtor i Drejtoratit të Regjistrimit mbi Pronat e Paluajtshme në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

- Më Vendimin me Nr.213/23 të datës 14.03.2023, të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ankuesi ishte caktuar fillimisht zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ndërsa, sipas Vendimit me Nr. 309 të datës 20.09.2024 dhe Vendimit me numër protokolli 4795/25 të datës 19.06.2025 të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ashtu që, pozitën e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të AKK-së e ka ushtruar nga data 20.09.2024 deri me 24.03.2026.

- Ministrja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më datë 25.03.2026, ka nxjerrë Vendimin me Nr. 06/2026, ku në pikën 1 të dispozitivit nëpunësi civil F.K është caktuar ushtrues i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ndërsa, më pikën 3 të dispozitivit është shfuqizuar Vendimi Nr. 4795/25 i datës 19.06.2025.

- Ankuesi kundër këtij vendimi kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit A.nr.383/2026, ka aprovuar ankesën e palës ankuese duke e anuluar vendimin e kontestuar.

-Ministrja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në kuptim të zbatimit të Vendimit A.nr.383/2026 të KPMSHC-së, më datë 21.05.2026 ka nxjerr Vendim me Nr. 15/2026 për caktimin e A.TH si ushtruese e detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

-Më Vendimin me Nr. 40/26 të datës 26.05.2026 të u.d. Drejtores Ekzekutive të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. F.K është caktuar ushtrues detyre i Departamentit të Gjeoinformacionit në këtë agjenci.  
- Ministria e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më datë 29.05.2026, ka nxjerrë Vendimin me numër protokoli 01-M 2959/26, me të cilin z. F.K është caktuar ushtrues i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

## *II. Pretendimet ankimore*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin me numër protokoli 01-M 2959/26, të datës 29.05.2026, të Ministres së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbi pretendimet se më vendimin e kontestuar është shkelur Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shton se caktimi i ushtruesit të detyrës nuk është bërë nga kategoria pasuese në vartësi të pozitës që caktohet, që është kriter ligjor dhe se ankuesi mbanë pozitë të kategorisë pasuese në raport me pozitën Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, kurse zyrtari i caktuar si ushtrues detyre sipas vendimit të kontestuar nuk mbanë pozitën e kategorisë pasuese, pasi që paraprakisht i njëjti është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të Departamenti pastaj ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv. Me tej, ankuesi pretendon se sipas vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 të këtij ligji. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet vendimi i kontestuar dhe të obligohet Ministri i MMPH që të bëjë caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

## *III. Pretendimet e ministrisë sipas përgjigjes në ankesë*

Ministria e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes përgjigjes në ankesë të datës 23.06.2026, pretendon se me aktin e kontestuar palës ankese nuk i është cenuar një e drejtë apo interes juridik nga marrëdhënia e punës, dhe rrejdhimisht nuk ka legjitimitetin e palës në procedurë dhe si të tillë nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmëri të ankesës. Po ashtu pretendon se pretendim për ushtrues detyre mbi ushtrues detyre, nuk është se ky pretendim nuk e tejkalon mungesën e legjitimitetit aktiv të ankuesit dhe nuk e bënë ankuesi palë të dëmtuar në asnjë rrethanë juridike, sikurse nuk qëndron pretendimin se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me nenin 47 dhe 52 të LPPA-së. Propozon që ankesë të hedhet poshtë si e palejuar dhe nëse KPMSHCK, shqyrton çështjen në meritë atëherë propozon që ankesë të refuzohet në tërësi.

## *IV. Vlerësimi i Kolegjit*

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës konstaton se e njëjta është e lejueshme 27 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe e njëjta është e pranueshme në kuptim të nenit 14 paragrafi 1, nenit 124 paragrafi 1, nenit 127 paragrafi 1 dhe 3 ndërlidhur me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji Këshillit lidhur me statusin juridik të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, i'u referua bazës ligjore si më poshtë:

-Ligjit Nr.08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, me theks të veçantë nenit 9 dhe 10 ku përcaktohet se: Neni 9 *1. Institucionet përgjegjëse në fushën e kadastrit organizohen në këtë strukturë organizative: 1.1. Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe 1.2. Zyrrat Kadastrale Komunale si pjesë përbërëse të AKK-së. 2. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës në AKK dhe ZKK-të përcaktohet me rregullore të cilën e miraton Kryeministri.....* Neni 10: *1. Agjencia Kadastrale e Kosovës, vepron si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë duke kryer funksion administrativ, dhënie të shërbimeve publike dhe zbatim të politikave.....”.*

-Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, ashtu që sipas shtojcës 1 Agjencia Kadastrale e Kosovës është renditura me numrin rendor 44 si Agjenci Ekzekutive, gjegjësisht, sipas nenit 22 të këtij ligji parashihet se: *Drejtimi i Agjencisë Ekzekutive 1. Agjencia Ekzekutive drejtohet nga drejtori ekzekutiv. 2. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese sipas ligjit për zyrtarët publikë. 3. Drejtori ekzekutiv për performancën dhe veprimtarinë e Agjencisë, i përgjigjet ministrit dhe informon Sekretarin e Përgjithshëm.* Ndërsa, me nenin 26 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji parashihet se: *1. Agjencia Ekzekutive dhe ajo Rregullatore organizohet si një apo disa departamente në bazë të fushë veprimtarisë. Niveli i organizimit përcaktohet në pajtim me këtë ligj. 2. Rregullat për organizimin e brendshëm të ministrive, sipas nënparagrafëve 1.2, 1.3 dhe paragrafit 2 të nenit 15, si dhe neneve 19 deri 21 të këtij ligji, zbatohen për organizimin e brendshëm të Agjencisë Ekzekutive dhe Agjencisë Rregullatore, në përputhje me nivelin e organizimit, përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.*

-Rregullores (ZKM) Nr13/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ku sipas nenit 4, paragrafi 1, është përcaktuar: *“1. Struktura organizative e AKK-së është si vijon: 1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv; 1.2. Departamentet; dhe 1.3. Divizionet.*

Referuar përcaktimit ligjor si më sipër dhe bazuar në shkresat e lëndës rrjedhë fakti i pa kontestuar se Agjencia Kadastrale e Kosovës, si Agjenci Ekzekutive udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv, si pozitë e kategorisë së lartë drejtuese siç parashihet me nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, duke pasuar më organizmin struktural departamente dhe divizione.

Në kuptim të themelësisë së pretendimeve ankimore, e në zbatim të mandatit kushtetues dhe ligjor të KPMSHCK-së lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, Kolegji ka analizuar aktin e kontestuar me ankesë në ndërlidhje me legjislacionin në fuqi që rregullon institutin e ushtruesit të detyrës, gjegjësisht nenin 35 të Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin përcaktohet se: *1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit..”* si dhe nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: *1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit*

*bazik ndryshohet si në vijim: 1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari...dhe si rrjedhojë, Kolegji konstaton së dispozitat lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës janë të karakterit imperativ, ushtruesi i detyrës vije në shprehje vetëm tek pozita drejtuese dhe si ushtrues detyre i pozitës përkatëse mund të caktohet vetëm zyrtari i kategorisë pasuese vartëse.*

Në ndërlidhje më këtë konstatim, dhe duke u bazuar në provat materiale të çështjes Kolegji erdhi në përfundimin se fillimisht kemi të bëjmë me një procedurë administrative e cila i ka paraprijë vendimit të kontestuar, rrjedhimisht, fillimisht z. F.K, sipas Vendimit me Nr. 40/26 të datës 26.05.2026 të u.d Drejtores Ekzekutive të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, është caktuar ushtrues detyre i Departamentit të Gjeoinformacionit në këtë agjenci e pastaj me vendimin e kontestuar është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, pra vendimi i kontestuar me ankesë sipas Kolegjit të Këshillit, nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi i cili rregullon caktimin e ushtruesve të detyrës, ngase bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se z. F.K nuk ka akt emërim të konfirmuar për pozitë të kategorisë së mesme drejtues e cila është kategori pasuese e pozitës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, kështu që në rrethanat juridike të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë ushtruesi i detyrës caktohet vetëm nëpunësi i kategorisë pasuese që është duke e mbajtur pozitën me akt të konfirmuar, pra me akt të emërimit, e në rrethanat e rastit konkret kjo nuk ka ndodhur, sepse sipas Vendimit me Nr. 01/15 të datës 27.02.2015, vërtetohet se nëpunësi civil z. F.K është i emëruar në pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për IKIH, pozitë kjo që në kuptim të Rregullores (ZKM) Nr13/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, konsiderohet pozitë ekuivalente me pozitën e Udhëheqësit të Divizionit apo pozitë e kategorisë së ulët drejtuese.

Përkitazi më këtë, Kolegji i Këshillit, konstaton se organi i punësimit me rastin e caktimit të nëpunësit përkatës në pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita të aplikueshme ligjore të përcaktuara më lartë dhe që ndërlidhen me këtë çështje, ngase në rastin konkret është dashur të caktoj një zyrtar të lartë nga kategoria pasuese, apo thënë më konkretisht një zyrtarë që mbanë me Akt emërim pozitën e kategorisë së mesme drejtuese.

Pra, mbi rrethanat si me sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se caktimi i ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të AKK-së sipas Vendimit me numër protokolli 01-M 2959/26 të datës 29.05.2026, të Ministres së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie ndesh me dispozitat ligjore të nenit 35 të Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik. Kështu që, mbi këto fakte, vendimi i kontestuar i'a cenon ankuesit të drejtën e caktimit potencial si ushtrues të detyrës në pozitën përkatëse, por kjo nuk nënkupton domosdo emërimin e ankuesit si ushtrues i Drejtorit Ekzekutiv të AKK-së, sepse, nëse brenda organit përkatës të punësimit ekzistojnë pozita të nivelit të njëjtë me pozitën e ankuesit, caktimi i ushtruesit të detyrës mbetet në diskrecion të titullarit të institucionit, por çdo herë duke respektuar kriteret ligjore të përcaktuar me ligj.

Nisur nga konstatimi si me sipër se akti i kontestuar nuk është në përputhje me kërkesat ligjore, duke vlerësuar se akti i kontestuar me ankesë nuk përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ të përcaktuar me dispozitat e nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, atëherë, çdo akt i nxjerrë në kundërshtim me dispozitat procedurale dhe materiale është akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara. Për me tepër sipas shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur meqenëse Ministria e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në kuptim të zbatimit të Vendimit A.nr.383/2026 të KPMSHC-së, më datë 21.05.2026 ka nxjerr Vendim me Nr. 15/2026 për caktimin e A.TH si ushtruese e detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, atëherë nuk është gjetur asnjë akt me të cilin është shfuqizuar, po ashtu Vendimi me Nr. 15/2026 i datës 21.05.2026 nuk është shfuqizuar apo anuluar me vendimin e kontestuar nga pala, e si rezultat i kësaj, Kolegji vlerëson se kemi dy akte juridike të nxjerra për të njëjtën çështje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi, 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht, aprovoj ankesën si të bazuar, shfuqizoj Vendimin numër protokoli 01-M 2959/26, të datës 29.05.2026, të Ministres së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me obligimin që kjo e fundit emërimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të AKK-së ta bëjë në pajtim me nenin 35 të Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda: A.nr.624/2026*

**Avdyl BEKTESHI**

*Procesmbajtës*

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

### **Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Hajzer Salihu;
- Ministres së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHC- së.